



## PROJEKTET E FINANCUARA NGA LEVIZ ALBANIA NËN INSTRUMENTIN E REAGIMIT TË SHPEJTË

<b>Emri i Organizatës:</b>	Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit
<b>Titulli i projektit:</b>	Për një zhvillim të qëndrueshëm të Luginës së Valbonës.
<b>Zona/t e zbatimit:</b>	Bashkitë Valbonë, Kelmend, Theth
<b>Qëllimi i projektit:</b>	Projekti synoi forcimin e bashkëpunimit me komunitetin me qëllim informimin e tyre mbi impaktin e ndërtimit të hidrocentraleve në Luginën e Valbonës si dhe përfaqësimin e tyre në dëgjesat publike bazuar në ligjet në fuqi.
<b>Rezultatet e arritura:</b>	Projekti u zbatua nga Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit i cili në kuadër të këtij projekti realizoi analizën ligjore të procedurave për miratimin e licencave për hidrocentralet në Parkun Kombëtar të Luginës së Valbonës. Dokumenti i hartuar nga ekspertët e projektit evidentoi mospërputhjen e zbatueshmërisë së ligjit mbi koncesionet si dhe mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga firmat e ndërtimit. Dokumenti zyrtar iu dorëzua institucioneve ligj-zbatuese dhe politik-bërëse nëpërmjet të cilit sygjerohej përmes ekspertizës ligjore dhe teknike ndërtimi i hidrocentraleve jashtë Parkut Kombëtar të Valbonës.
<b>Emri i Organizatës:</b>	Aleanca Kundër Importit të Plehrave (AKIP)
<b>Titulli i projektit:</b>	Ndalimi i ligjit që lejon importin e plehrave në territorin e Shqipërisë
<b>Zona/t e zbatimit:</b>	Projekt Kombëtar
<b>Qëllimi i projektit:</b>	Projekti synoi ndalimin e miratimit të projektigjit/ligjit që parashikonte importin e mbetjeve në Territorin e Republikës së Shqipërisë.
<b>Rezultatet e arritura:</b>	Aleanca kundër Importeve të Plehrave (AKIP) kontriboi në anulimin e Projektligjit nr. 92/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10463, dt. 22.09.2011, "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", ligj i propozuar nga qeveria i cili u ridërgua në Parlament pas mosdekretimit nga Presidenti në Tetor 2017. AKIP realizoi disa protesta në kuadër të këtij projekti në fokusin e të cilave ishte ndërgjegjësimi i qytetarëve përmes informimit si dhe ndryshimin e qasjes së aktorëve politik-bërës dhe vendimtarës për të anuluar ligjin në fjalë. AKIP zhvilloi fushata me ndikim të ndjeshëm në kanalet e mediave sociale duke zgjuar dhe reagimin qytetar ndaj kësaj çështje. Po në kuadër të projektit të mbështetur nga LA, AKIP zhvilloi një tryezë të rrumbullakët në të cilën u mblodhën aktorët e shoqërisë civile, ekspertë mjedisorë, qytetarë dhe aktivistë të cilët u informuan mbi impaktin mjedisor dhe rreziqet që importi i mbetjeve do ti sillte vendit. Në sajë të presionit të vazhdueshëm të zhvilluar nga AKIP u zhvillua një protestë masive përpara godinës së Parlamentit të Shqipërisë ditën e votimit të dekretit të Presidentit për rrëzimin e ligjit për importin e mbetjeve. Nisma e AKIP shënon një nga sukseset më të rëndësishme të shoqërisë civile në Shqipëri.



## PROJEKTET E FINANCUARA NGA LEVIZ ALBANIA NËN INSTRUMENTIN E REAGIMIT TË SHPEJTË

<b>Emri i Organizatës:</b>	Shoqata e Përfitimit Fizik, Korçë
<b>Titulli i projektit:</b>	Fushatë ndërgjegjësuese për anulimin e projektligjit "Për miratimin e ndryshimit të statusit të një toke bujqësore, me sipërfaqe 288,4 hektarë, në zonë minerare, për shfrytëzimin e torfave për prodhimin e energjisë elektrike", në tokat bujqësore të ish-kënetës Maliq.
<b>Zona/t e zbatimit:</b>	Bashkia Korçë
<b>Qëllimi i projektit:</b>	Projekti synoi të anulojë projektligjin për shndërimin e tokës në zonë minerare dhe tërheqjen nga qeveria të këtij projektligji nga Kuvendi, vënien në dispozicion për përdorim të kësaj toke bujqësore komunitetit dhe sipërmarrësve privatë për sigurimin e produkteve bujqësore e blegtorale.
<b>Rezultatet e arritura:</b>	Shoqata e Përfitimit Fizik krijoi Koalicionin për Mbrojtjen e Tokave Torfike, i përbërë nga 20 anëtarë, përfaqësues të Oorganizatave Jo Fitimprurëse lokale, akademikë, anëtarë të Komisionit Këshillimor Qytetar, të cilët rritën ndërgjegjësimin në komunitet dhe në insitucionet e qeverisjes vendore përmes dëgjësave publike mbi dëmet domethënëse në pronën private dhe publike, mjedisin dhe shëndetin e banorëve në Maliq, efekte që rrjedhin nga zbatimi i projektligjit " Për miratimin e ndryshimit të statusit të një toke bujqësore, me sipërfaqe 288,4 hektarë, në zonë minerare, për shfrytëzimin e torfave për prodhimin e energjisë elektrike". Qytetarët të shumë të numër shprehën mbështetjen e tyre ndaj kësaj nisme duke u bërë pjesë e nënshkrimit të peticioneit online në internet.
<b>Emri i Organizatës:</b>	Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë (AOS)
<b>Titulli i projektit:</b>	Stop urbanizimit të parkut kombëtar Divjakë – Karavasta.
<b>Zona/t e zbatimit:</b>	Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta Bashkia Divjakë, Institucionet Qendrore në Tiranë.
<b>Qëllimi i projektit:</b>	Projekti synoi mobilizimin dhe koordinimin sa më të shpejtë të të gjitha përpjekjeve dhe burimeve njerëzore të mundshme për të grumbulluar sa më shumë argumente ligjore dhe mbështetje qytetare në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për të ndaluar pranimin dhe zbatimin e planit të të propozuar për ndërtimin e një zone të re urbane me efekte shkatërruese në mjedis dhe në ekonominë vendore në zonën e Divjakës
<b>Rezultatet e arritura:</b>	Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë arriti të rrisë ndërgjegjësimin për të parandaluar urbanizimin e parkut kombëtar Divjakë-Kravasta nga plani i zhvillimit turistik nga grupi MABETEX. Kjo u arrit përmes forumeve publike, mediave lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, spoteve dhe një filmi dokumentar "Super resorti që rrezikon Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta". Ekspertiza teknike dhe ligjore e AOS për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Financave, Ekonomisë dhe Punës dhe AIDA (Agjencia Shqiptare për Zhvillim dhe Investime) vendosi statusin e "Vlerësimit Strategjik Mjedisor" nga investitori si dhe pezulloi miratimin dhe zbatimin e planit të



## PROJEKTET E FINANCUARA NGA LEVIZ ALBANIA NËN INSTRUMENTIN E REAGIMIT TË SHPEJTË

propozuar për ndërtimin e një zone të re urbane me ndikim shumë negativ në mjedis dhe në ekonominë lokale.

**Emri i Organizatës:**

**Titulli i projektit:**

**Zona/t e zbatimit:**

**Qëllimi i projektit:**

Aleanca Kundër Importit të Plehrave (AKIP II)

Prapësim inceneratorëve, portave të importit të plehrave (PIPIP) - Rasti i Fierit.

Bashkia Fier

Projekti synoi që të bëhnte të qartë publikun dhe institucioneve vendimmarrëse lokale dhe qendrore se ndërtimi i inceneratorëve është një opsion i papërshtatshëm dhe i rrezikshëm për Shqipërinë. Qëllim tjetër i AKIP ishte përcaktimi i një skemë për menaxhimin mbetjeve në qytetin e Fierit, që të sigurohej një menaxhim më pak i rrezikshëm dhe me kosto më të ulët në kushtet e Shqipërisë.

**Rezultatet e arritura:**

AKIP, një grup aktiv i avokimit mjedisor për menaxhimin e mbetjeve, mobilizoi komunitetet lokale në Fier dhe shoqërinë civile në Shqipëri për të kundërshtuar PPP (Partneritetin Publik Privat) për përdorimin e inceneratorëve si një teknologji e menaxhimit të mbetjeve përballë një menaxhimi të integruar të tyre, duke u mbështetur në parimin e reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve. AKIP organizoi tre protesta publike ku 600 persona morën pjesë kundër inceneratorit në Fier: dy në vendin e inceneratorit dhe një para Parlamentit të Shqipërisë në të njëjtën kohë me dëgjuesën parlamentare nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për këtë çështje.

Publiku u informua në tryeza të rrumbullakëta dhe në median tradicionale dhe mediat sociale për rreziqet mjedisore dhe shëndetësore të inceneratorëve ku u evidentua se vendi i zgjedhur në toka bujqësore paraqet rreziqet më të larta të ndotjes së mjedisit. Një plan alternativ i menaxhimit të integruar të mbetjeve u propozua nga AKIP në Bashkinë Fier i përgatitur në konsultim të ngushtë me ekspertë të huaj.

Përveç kësaj, AKIP, në bashkëpunim me Klinikat e Ligjit (OSFA) projekt i financuara nga LA (përmes instrumentit SEI), mori masa ligjore kundër vendimit për ndërtimin e inceneratorit në Fier dhe rasti ishte në Gjykatën e Apelit në kohën e vlerësimit. Si rezultat i ndërgjegjësimit dhe advokimit nga AKIP, rasti i inceneratorit të Fierit u kthye në një çështje e ndjeshme e interesit publik dhe si rrjedhojë qeveria nuk ka përparuar në iniciativën e saj për të ndërtuar inceneratorin në Tiranë

**Emri i Organizatës:**

**Titulli i projektit:**

**Zona/t e zbatimit:**

**Qëllimi i projektit:**

TOKA: Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Alpeve Shqiptare Për Valbonën, Për Shqipërinë.

Bashkitë Tiranë dhe Tropojë

Projekti synoi pezullimin e menjëhershëm të ndërtimit të HEC-ëve në Parkun Kombëtar të Luginës së Valbonës, dhe zbatimin e



## PROJEKTET E FINANCUARA NGA LEVIZ ALBANIA NËN INSTRUMENTIN E REAGIMIT TË SHPEJTË

plotë të ligjit për konsultimet publike dhe përfshirjen e banorëve lokal në vendimarrjet e institucioneve vendore.

### **Rezultatet e arritura:**

Në kuadër të projektit të mbështetur nga LA, TOKA realizoi një takim dy-ditor në Tropojë me pjesëmarrjen e trupit diplomatik (Ambasadorit Amerikan, Kreut të OSBE dhe Kreut të UNDP), kompanisë ndërtuese Gener2, si dhe të 150 qytetarëve/banorëve, takim ku u diskutua rreth çështjes së ndërtimit të hidrocentraleve në Valbonë. Ky takim rezultoi një debat konstruktiv dhe u dha mundësinë qytetarëve të shprehnin shqetësimet e tyre rreth kësaj çështjeje. U mbajt gjithashtu një takim me Presidentin e Republikës Z.Illir Meta të cilit iu u kërkuar pezullimi i punimeve të HEC në Valbonë. TOKA zhvilloi një takim me Zëvendës Ministrin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Z. Hajrulla Ceka për të pezulluar ndërtimin e HEC-eve. U nënshkruar on-line nga 3036 persona peticioni i hatuar nga TOKA në kuadër të këtij projekti i cili shprehej kundër ndërtimit të HEC-eve në Luginën e Valbonës. Fushata ndërgjegjësuere dhe informuese u zhvilluan paralelisht në Tropojë dhe Tiranë përmes ku u përdor shumëllajshmëria e kanaleve të komunikimit, nga reklamat në rrugët e Tiranës, broshura e shpërndara dorë më dorë me qytetart në Tropojë. Një faqe interneti [<http://pofletvalbona.org>] u ndërtua për të informuar qytetarët sa më shumë projektin dhe impaktin mjedisor, ekonomik dhe turistik që do të sillte ndërtimi i HEC-eve në Valbonë. Një instalacion artistik u vendos në Sheshin Skendërbej ku u realizua me zë dhe figurë rrjedha e lumit Valbona.

### **Emri i Organizatës:**

Federata Shqiptare e Rafting

### **Titulli i projektit:**

Mbrojtja e Kanioneve të Osumit si monument i natyrës.

### **Zona/t e zbatimit:**

Bashkitë Skrapar, Berat, Tiranë

### **Qëllimi i projektit:**

Projekti synoi të anullopë procedurat për ndërtimin e HEC-ve mbi Kanionet e Osumit.

### **Rezultatet e arritura:**

Projekti i zbatuar nga Federata Shqiptare e Rafting është një histori suksesi në mbrojtjen e monumenteve të natyrës përmes advokimit të koordinuar me median lokale dhe qendrore, ndërgjegjësimin të publikut dhe veprimeve konkrete në aspektin ligjor. Granti pati sukses në mobilizimin e komuniteteve lokale dhe mediave dhe ja doli të rrisë ndërgjegjësimin e publikut mbi impaktin negtiv që hidrocentralet mund të duke shkaktuar dëme të pakthyeshme në mjedis, ekonominë lokale, dhe turizmin. Një seminar/takim informues i organizuar me mediat dhe gazetarë solli një mbulim të lartë mediatik në nivel kombëtar mbi ndikimin mjedisor në këto monumente të natyrës dhe sensibilizimin e publikut të gjerë. Paralelisht, projekti mobilizoi ekspertizën teknike për të përcaktuar koordinatat e zonës së mbrojtur dhe raportoi se hidrocentralet që do të ndërtohen në zemër të kanioneve do të çojnë në shkatërrimin e tyre. Këto gjetje u pasuan nga veprime ligjore, ku u përfshinë shoqëria civile dhe Klinikat e Ligjit (OSFA) të financuara nga LA (përmes



## PROJEKTET E FINANCUARA NGA LEVIZ ALBANIA NËN INSTRUMENTIN E REAGIMIT TË SHPEJTË

instrumentit SEI), duke kontribuar në anulimin e licencës mjedisore për dy hidrocentrale. Një tjetër kërkesë për anulim license është duke u ndjekur në rrugët ligjore.

**Emri i Organizatës:** Shoqata “Lëvizja Ecovolis”  
**Titulli i projektit:** Aktivizimi i 300 të rinjve për lumenj dhe bregdet të pastër.  
**Zona/t e zbatimit:** Zonat bregdetare të Vlorës dhe Sarandës  
**Qëllimi i projektit:** Projekti synoi të informonte publikun e gjerë mbi ndotjen nga mbetjet urbane në bregdetin jugor si dhe të nxiste një lëvizjeje qytetare për të vënë përpara përgjegjësisë institucionet përkatëse.  
**Rezultatet e arritura:** Projekti i zbatuar arriti të përmirësojë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në Bashkitë e Vlorës, Himarës dhe Sarandës dhe njësisive administrative nën hartën e këtyre bashkive, nëpërmjet vendosjes së rreth 300 kontenierëve të rinj.

10 pika turistike në 6 zona të bregdetit jugor u pastruan (Jalë, Vuno, Borsh, Dhërmi, Himarë dhe Qeparo),përmes angazhimit të 300 të rinjve vullnetarë në zonat më të frekuentuara nga vizitorët përgjatë bregdetit si dhe në zonat e banuara ku u angazhuan 30 të rinj në fushatën e pastrimit. Informimi dhe dërgëgjësimi i së paku 500 banorëve të zonës dhe i 50 përfaqësuesve të bizneseve në zonat e Vunoit dhe Jalës, lidhur me përgjegjësinë e pushtetit lokal për pastrimin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane si dhe përfshirja e tyre në procesin e monitorimit dhe llogaridhënies ndaj institucioneve vendore dhe kontributit që ata duhet të japin në mbrojtjen e mjedisit. U realizua mbledhja e 300 fotografive dhe videove për pasqyrimin e gjendjes problematike, duke i shpërndarë gjerësisht në mediat sociale. Projekti monitoroi 10 pikave të ndotura në Jalë, Dhërmi, Vuno dhe Qeparo nga 5 aktivistë përgjatë periudhës Gusht-Shtator, nga ku rezultoi se pati më pak ndotje pas vendosjes së kontenierëve të rinj. Denoncimi i 2 rasteve flagrante mbi ndotjen nga mbetjet urbane në kthesën e Jalit dhe ndotjen e përroit të Vunoit, që kishin nevojë të menjëhershme për t’u pastruar, duke ushtruar presion tek institucionet përgjegjëse përmes evidentimit të gjendjes tek publiku dhe mediat. Realizimi i një dokumentari për ndërgjësimin e komunitetit dhe të përfaqësuesve të pushtetit vendor mbi dëmet që shkakton në shëndet ndotja e mjedisit nga mbetjet urbane si dhe nxitja për ndërmarrjen e politikave të menaxhimit të qendrueshëm të mbetjeve urbane; Gjithashtu u përgatitën 5 mini-video që evidentonin ndotjen mjedisore mbi dhe nën uje nga qytetarët, turistët dhe bizneset sezonale

**Emri i Organizatës:** Shoqata “Vizion i Gjellbër”  
**Titulli i projektit:** Kush është ajo dorë, që na shkruan fatin!?  
**Zona/t e zbatimit:** Bashkia Selenicë  
**Qëllimi i projektit:** Projekti synon që të ngrejë zërin e banorëve të zonës në nivel vendimmarrës.  
**Rezultatet e pritshme\*:** Objektivi kryesor është ngritja e lëvizjes komunitare për vetëveprim lidhur me shqetësimin e tyre në fshatrat e targetuara



## **PROJEKTET E FINANCUARA NGA LEVIZ ALBANIA NËN INSTRUMENTIN E REAGIMIT TË SHPEJTË**

nëpërmjet: evidentimit të shkeljeve të koncesionarit; informimit me të drejtat e tyre, ndikimin në mjedis, ndikimin në ekonominë e tyre bujqësore dhe blektorale, kulturën dhe trashëgiminë, klimën, shëndetin; inkurajimit të vazhdueshëm gjatë takimeve me banorët si dhe mediatizimit të vazhdueshëm të ngjarjeve.

**\*Ky projekt është ende në zbatim**